Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0972

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga; Isa Hasani-Kryetar, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së (OE) "Internat Security Association" Sh.P.K, kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të "Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurim fizik i objekteve për nevojat e MINT" me nr. të prokurimit: "204-23- 7170-2-1-1" më 13/02/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Internat Security Association" Sh.P.K, me nr. 2023/972 e datës 04/12/2023, kundër vendimit të AK "Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurim fizik i objekteve për nevojat e MINT" me nr. të prokurimit: "204-23-7170-2-1-1".

2. Mbetet në fuqi, "Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues " i datës, 17.11.2023,për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurim fizik i objekteve për nevojat e MINT" me nr. të prokurimit: "204-23- 7170-2-1-1" i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13.07.2023, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Sigurim fizik i objekteve për nevojat e MINT" me nr. të prokurimit: "204-23- 7170-2-1-1". Ndërsa me datën 17.11.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "Rojet e Nderit" Sh.P.K.".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 380,000.00 €.

Me 21.11.2023, OE "Internat Security Association" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 29.11.2023;, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 04/12/2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Internat Security Association" SH.P.K me nr. 972/23 për lidhur me aktivitetin "Sigurim fizik i objekteve për nevojat e MINT" me nr. të prokurimit: "204-23- 7170-2-1-1" .

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Internat Security Association" Sh.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I):Ankuesi pretendon: " Duke pas parasysh se ne si OE palë me interes në këtë AP, kemi ofertuar sipas kërkesave të AK për këtë AP, jemi të habitur se si AK ka shpallur fitues një kompani e cila është e papërgjegjshme financiarisht, pse po e cekim këtë do ju ofrojmë argumentet si në vazhdim: 1. Dosja e tenderit dhe kërkesat e saj në Aneks 1 për pagat e punëtorëve dhe numrin e punëtorëve të caktuar nga vetë AK, sipas këtyre kërkesave ne edhe kemi ofertuar me ofertën tonë ku kemi llogaritur pagat saktë dhe disa të drejta të dala nga ligji I punës së Republikës së Kosovës, për të cilin pretendim ne do të ofrojmë llogaritjen dhe pyetjet e bëra nga AK kundrejt nesh. AK ka kërkuar që numri i punëtorëve të jetë 28 punëtor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit sipas kërkesës së evidentuar te Aneks 1 specifikimet teknike të detyrueshme (shih kërkesën e AK si më poshtë). Sqarim: 1. Shpërndarja e punëtorëve (rojeve) duhet të bëhet në koordinim me autoritetin kontraktues, përcaktimi i pikave, i numrit, i shpërndarjes së rojeve...etj. 2. Numri i Objekteve dhe/ose numri i rojeve mund të rritet apo të zvogëlohet, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktues që mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së kontratës. 3. Numri i përafërt i punëtorëve (rojeve) do të jetë rreth njëzet (28) persona (OE duhet të na dëshmojë kontratat e punës si dhe vërtetimin nga ATK që paguan taksat dhe kontributet për punëtoret). 4. Objekti i Industrisë Kimike, Parku i Biznesit në Drenas dhe në Z.K. Bërnicë e Epërme me lokacion në "Bardhosh", Prishtinë posedojnë rrethoja që nënkupton sigurimin e tyre (rrethojës) dhe hapësirave brenda tyre. 5. Orari i punës për punëtoret (rojet) duhet të jetë në përputhje me orarin e caktuar në Ligjin e Punës (40 orë pune në javë). 6. Në rast te humbjes apo vjedhjes së ndonjë gjësendi në kohen e siguruar nga ana e Kompanisë, kompania duhet te përgjigjet brenda 10 ditëve nga humbja apo vjedhja duke e kompensuar demin e shkaktuar. Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është 30 % Vërejtje: Pagat e punëtoreve nuk duhet të jenë më të ultë se 350.00.00 € neto. " Këtë kërkesë AK e ka anashkaluar plotësisht dhe në mënyrë të një anshme duke favorizuar OE fitues edhe pse ky OE nuk e plotëson këtë kushtë fare, e për që nuk e plotëson ne do ju japim shpjegimin saktë dhe qartë në lidhje me këtë vërejtje tonë në këtë procedurë ankimore. Ne ju kemi dërguar një analizë financiare të cilën AK e ka kërkuar përmes në letre standarde për sqarim e tenderit të datës 01.11.2023, ku është kërkuar që sqarimet tona të ipen bazuar kërkesës së dosjes së tenderit respektivisht kërkesës së Aneks 1 për pagat" Në kuadër të dosjes se tenderit AK-MINT ka kërkuar qe paga e një punëtori neto nuk duhet te jete me e ulët se 350 euro, dhe orari i punës për punëtoret (rojet) duhet të jetë në përputhje me orarin e caktuar në Ligjin e Punës (40 orë pune në javë).andaj bazuar ne këto kërkesa ligjore te specifikuara ne dosjen e tenderit dhe për të vlerësuar drejtë dhe sipas LPP-së ofertën tuaj ju duhet të bëni

sqarimin se si e keni llogaritur çmimin njësi ore për punëtor (kalkulimi te behet vetëm për një punëtor) bazuar ne çmimin njësi te ofruar tek pjesa e përshkrimit të çmimit ku janë te përfshira sasia e orëve." Ne ju kemi dërguar analizën financiare të cilën e gjeni të bashkangjitur ne ankese. Siç edhe mund të shifni bazuar në analizën tonë e cila është e saktë minimum i çmimit të ofertuesve në këtë rast vetëm duke llogaritur pagat e kërkuara do të duhej të ishte në pragun e çmimit me TVSH 320855.40 euro, çmimi i ofertës sonë 339,009.00 euro mbi pragun e lejuar , ku janë kalkuluar pagat dhe zëvendësimet për pushime vjetore, atëherë si është e mundur që OE i shpallur fitues të mbulojë kërkesën e juaj financiare, kjo është diskriminuese dhe në kundërshtim me ligjin e prokurimit pasi që keni bërë shkelje të kushteve për pjesëmarrje në tender të OE ofertues e posaçërisht keni bërë shkelje të nenit 7, neni 27, nenit 59 të LPP-së. OE i shpallur fitues është me ofertë afër 20000.00 euro nën paga."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Internat Security Association" SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 27, 59 të LPP-së. Andaj kërkojmë nga OSHP që kjo ankesë të merret e bazuar dhe AP të kthehet në rivlerësim duke respektuar pragun e ofertave për pagat e punëtorëve në vlerë prej 320855.40 euro, duke i klasifikuar ofertat nga ky çmim e të lartë.

Përgjigje e Autoriteti Kontraktues në Kërkesën për rishqyrtim, të OE ankues "Internat Security Association" Sh.P.K.

Si Autoritet Kontraktues Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) me datën 13.07.2023 ka tenderuar në procedurën e hapur për tenderin: "Sigurim fizik i objekteve për nevojat e MINT - MINT204-23-7170-016-2-2-1, sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/ L-042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/ L-237 Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/ L-237. Në procesin e hapjes me datë 07.09.2023 kemi pranuar shtatë (7) oferta nga operator ekonomik lë interesuar për këtë aktivitet të prokurimit. Komisioni i vlerësimit pasi ka bërë vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave respektivisht ka ardhur në përfundim se operatori Internat Security- Associacion SH.P.K. nuk është në përputhshmëri të plotë me të gjitha kërkesat dhe kriteret e përcaktuar në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit. Me datë 27.11.2023 janë njoftuar me njoftimin për tenderuesit e pasuksesshëm dhe me të njëjtën datë është ngritur vendimi mbi njoftimin e autoritetit kontraktues për këtë procedurë të prokurimit përmes platformës së E-prokurimit të KRPP-së.

Me datë 21.11.2023 kemi pranuar kërkesën për Rishqyrtim sipas kërkesës së tij, ankesë/kërkesën për rishqyrtim të vendimit të AK-MINT nga Internat Security Associacion Sh.P.K me pretendimin se është shkelur: Neni 7 LPP-së, Neni 27 LPP-së, dhe Neni 59 i LPP-së. Pas pezullimit të këtij aktiviteti me datë 23.11.2023, sipas dispozitave ligjore të LPP-së të nenit 108/ A, dhe në përputhje nenin 8.1.1 pika (ii) të rregullave për parashtrimin e ankesave të nxjerra nga KRPP-ja; Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar pikat e ankesës duke konstatuar se : Pikat e ankesës lidhur me Nenet lart shënuar, asnjëra nga këto pretendime nuk qëndrojnë pasi që fillimisht ju si OE nuk keni shprehur interesin material ne asnjë nga OE pjesëmarrës ne këtë procedure te prokurimit qe janë :me çmim me te lire se oferta juaj. Po ashtu kërkesa juaj për rishqyrtim e parashtruar më date 21.11.2023 nuk është e plotësuar apo e formalizuar sipas LPP-se dhe UOPP.

Nga e gjitha që u tha më lartë deklarojmë se komisioni ka bërë vlerësimin e ofertave në mënyrë të argumentuar të drejtë dhe korrekte duke trajtuar të gjithë OE pjesëmarrës në mënyrë të barabartë duke vlerësuar me kujdes të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në plotësimin e secilës kërkesë dhe kriter në dosjes konform legjislacionit në fuqi . Siç u tha me lartë si AK-MINT ka bërë vlerësimin e ofertave duke i shqyrtuar të gjitha pikat e ankesës të dorëzuar nga Internat Security Associacion SH.P.K, edhe se procesi i vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave është bërë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së, UOPP-së dhe akteve tjera nënligjore dhe në respektim të plotë të kritereve dhe kërkesave të specifikuara në dosje të tenderit. Prandaj sipas dispozitave ligjore të LPP-së të nenit 108/A, dhe në përputhje nenin 8.1.1 pika (ii) të rregullave për parashtrimin e ankesave te nxjerra nga KRPP-ja; Autoriteti Kontraktues e refuzon kërkesën e propozuar për shqyrtim si te pabaze sikurse ne dispozitiv te këtij vendimi."

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 972/23, ndërsa me datë 06.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/972 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe të gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet si më lartë) dhe rekomandon që të anulohet B58- njoftimit mbi vendimin AK (vendimit për dhënie të kontratës) dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, ndërsa OE ka deklaruar se Pajtohet me mendimin e ekspertit.

Vlerësimi i eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/972, të pretendimeve ankimore të OE ankues"Internat Security Association" SH.P.K, si në vijim;

Konstatimi i parë (I): "Lidhur me pretendimin ne këtë aktivitet te prokurimit te operatorit ekonomik ankues, se bazuar në analizën tonë e cila është e saktë minimum i çmimit të ofertuesve në këtë rast vetëm duke llogaritur pagat e kërkuara do të duhej të ishte në pragun e çmimit me TVSH 320855.40 euro, çmimi i ofertës sonë 339,009.00 euro mbi pragun e lejuar , ku janë kalkuluar pagat dhe zëvendësimet për pushime vjetore, atëherë si është e mundur që OE i shpallur fitues të mbulojë kërkesën e juaj financiare, kjo është diskriminuese dhe në kundërshtim me ligjin e prokurimit pasi që keni bërë shkelje të kushteve për pjesëmarrje në tender të OE ofertues e posa qërisht keni bërë shkelje të nenit 7 , neni 27 , nenit 59 të LPP- së. OE i shpallur fitues është me ofertë afër 20000.00 euro nën paga. Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, si dhe bazuar ne specifikat teknike te detyrueshme – Aneksi 1 te FDT-së, po jap sqarime te cilat i gjeni te bashkangjitur ne ankesë. ashtu, eksperti shqyrtues sqaron se bazuar në aneksin 1 të FDT-së, të përcaktuar nga AK lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ku janë specifikuar numri i përafërt i punëtorëve, paga neto, Ligji i Punës etj...., ku parashihen edhe pushimet vjetore dhe mjekësore si dhe fitimi që mund të rrjedhë nga ky aktivitet i prokurimit, dhe qe është dashur te vlerësohen/analizohen dhe te konstatohet ne raport nga komisioni i vlerësimit, andaj konsideroj se AK – komisioni i vlerësimit ka vepruar ne kundërshtim me nenin 7 par. 2 të LPP-së, ku thotë: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik", po ashtu marrë për bazë se AK – ZPP në vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk është lëshuar ne pretendimet e OE ankues me arsyetimin se OE ankues është palë pa interes ne këtë aktivitet të prokurimit, (andaj konsideroj se fillimisht duhet të trajtohen nga AK) nuk është i arsyetuar për faktin se AK – komisioni i vlerësimit dhe B058 njoftimi mbi vendimin e AK / letrat standarde OE i cili është me çmim më të lartë se sa OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është eliminuar /shpallur OE i pa përgjegjshëm, andaj është dashur të trajtohen nga AK. Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, nuk ka respektuar nenin 7, 59, 60 të LPP-së, andaj Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit– ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore të LPP-së, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 dhe ne dosje te tenderit si dhe të respektohen kriteret e dhënies. Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më

transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.”

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues vëren se me 13.07.2023, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Sigurim fizik i objekteve për nevojat e MINT” me nr. të prokurimit: "204-23- 7170-2-1-1", ndërsa me datën 17.11.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "Rojet e Nderit" Sh.P.K.”.

Paneli shqyrtues vëren se në Dosjen e Tenderit janë përcaktuar nga Autoriteti kontraktues, Kërkesat e përshtatshmërisë si, Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale e të për të cilat janë kërkuar të provohen me dëshmitë dokumentare. Operatori ekonomik ankues “Internat Security Association” Sh.P.K, në ketë aktivitet prokurimi asnjë pretendim ankimor nuk e ka ngritur sa i përket dëshmive dhe kërkesave te dosjes tenderit, kundrejt Operatori ekonomik të rekomanduar për kontrate lidhur me dëshmitë dokumentare të kërkuara.

Operatori ekonomik në ankesën e tij ka paraqitur vetëm një pretendim ankimor, që nuk përkon me kërkesat e Dosjes së tenderit, se Autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontrate një OE i cili ka ofertuar/aplikuar me çmim me të ulët dhe nuk mund ta përmbushë kontratën lidhur me pagat e punëtorëve, sipas Dosjes se tenderit. Eksperti shqyrtues ne raportin e tij e ka trajtuar pretendimin ankimor të OE “Internat Security Association” Sh.P.K , lidhur me ofertimin me çmim të ulet të operatorit te rekomanduar se OE nuk mund ti mbulojnë pagat e punëtorëve.Paneli shqyrtues vlerëson se në Dosjen e tenderit nuk është kërkuar kurrfarë dokument të Analizës Financiare nga ofertuesit lidhur me kalkulimin e pagave të punëtorëve dhe konsiderojmë se pretendimi ankimor nuk përkon dhe është në kundërshtim me kërkesat e DT dhe me nenin 53 paragrafi 3 i LPP-së, andaj dhe raporti i eksperti shqyrtues është i paqëndrueshëm dhe në kuptim vlerësimit të tij përfundimtar andaj dhe nuk mund të mbështet nga paneli.

Paneli shqyrtues vlerëson se neni 60 i LPP-se, Kriteret për Dhënien e Kontratës, ka përcaktuar se Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar, tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Autoriteti kontraktues në piken 31.1 të Dosjes së tenderit, si Kriteri i dhënies kontratës ka caktuar, Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët. Një ashtu Neni 56 I LPP-Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, në paragrafin 3 ka përcaktuar "*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".*

Paneli shqyrtues vëren se në Dosjen e tenderit në aneksin 1; Specifikimet Teknike të Detyrueshme, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar si në vijim" Shënim: Pagat e punëtorëve nuk duhet të jenë më të ulëta se 350.00.€ neto, ndërsa lidhur me ketë kërkesë operatori ekonomik i rekomanduar OE "Rojet e Nderit" Sh.P.K." në ofertën e tij, autoritetit kontraktues i ka dorëzuar deklaratë me shkrim që mban datën 15.08.2023 përmes se cilët konfirmon zbatimin e kësaj kërkese lidhur me pagën neto që duhet paguar si në vijim;" *Deklarojmë se pagat e punëtorëve në këtë projekt do të jenë konform kërkesës tuaj në nivelin 350 Neto*"

Paneli shqyrtues bazuar në dokumentin Dosja e tenderit i datës, 12.07.2023 dhe në Njoftim mbi Vendim i Autoritetit Kontraktues" Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "204-23- 7170-2-1-1", konstaton, se në ketë aktivitet prokurimi kanë ofertuar shtatë (7) operator ekonomik, ndërsa autoriteti kontraktues me vendimin e tij të datës ,17.11.2023, ka rekomanduar për ta shpërblyer me kontratë Operatorin ekonomik "Rojet e Nderit" Sh.P.K, ndërsa operatoret ekonomik të tjerë janë vlerësuar si të pasuksesshëm për arsyeje të mosplotësimit të kërkesave të Dosjes se tenderit dhe Autoritetit kontraktues, përmes Letrës B54-standarde për tenderuesin e eliminuar, me datë, 17.11.2023, i ka njoftuar ankuesin dhe OE te tjerët për arsyen e eliminimit.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik është e pa bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurim fizik i objekteve për nevojat e MINT" me nr. të prokurimit: "204-23- 7170-2-1-1", të mbetet në fuqi Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për dhënie të kontratës. Paneli Shqyrtues ka konstatuar se Autoriteti kontraktues ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP, pasi që AK ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese OE pjesëmarrës, duke u bazuar në dokumentacionin e prezantuar dhe dëshmitë dëshmuese me pas ka rekomanduar OE me ofertën më të lirë me çmim dhe të përgjegjshëm. Paneli Shqyrtues vlerëson se vlerësimi i tenderit është kryer sipas kërkesave të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dosjes së tenderit. Andaj, Paneli Shqyrtues konstaton se AK me të drejt ka shpërblyer OE e rekomanduar pasi që ka përmbushur gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit si dhe ka qenë tenderi me i përgjegjshëm me çmim me të ultë.

Paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç'rast konstatohet në mënyrë jo kontestuese se oferta e OE të rekomanduar për kontrate konsiston në një çmim me të lirë në raport me ofertën e ankuesit, ngase tek përshkrimi i çmimit vërehet se OE i rekomanduar ka ofertuar me çmim prej 305,601.00 euro, derisa OE ankues ka ofertuar me çmim prej 339,009.00 euro, dhe kemi një ndryshim te konsiderueshëm prej 33,408.00 euro, e që i kontribuon pikërisht këtij parmi ekonomicitetit në shfrytëzimin e buxhetit të institucionit.

Paneli Shqyrtues konstaton se duke u bazuar në të dhënat se aktiviteti është i llojit i kontratës Publike kornizë – Çmimi njësi të procedurës së hapur, dhe sipas Dosjes se tenderit Specifikimet teknike të detyrueshme – Aneks I, është përcaktuar Sasia e parashikuar është vetëm sasi indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është 30 %,me qenë se kemi sasi indikative për pozicion shërbime te

sigurimit, PSH konstaton oferta e OE ankues është më e lart me çmim se oferta e rekomanduar dhe ofertat tjera të OE pjesëmarrës janë të përafërta, që krijojnë bindjen se oferta e OE të rekomanduar nuk ka hapësirë manipulimesh si dhe krijim të vështirësive në implementim të kontratës, andaj PSH konstaton se lidhur me këtë, OE ankues nuk ka ofruar dëshmi argumente dhe të dhëna konkrete që dërgojnë të vërtetimi i pretendimit apo klasifikimi e tij si i bazuar, ndërsa mbete në diskrecion e AK-së (sipas dispozitave të LPP-së) që në këtë rast, duke pasur parasysh instrumentet ligjore që mund ti përdorë para dhe përgjatë implementimit të kontratës, siç janë rritja e sigurimit të ekzekutimit nenit 29 të Rregullores Prokurimit Publik nr.01/2020, e po ashtu aplikimi i nenit 63 LPP-së përgjatë të ekzekutimit te kontratës.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të pjesërishem të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**
- OE - **"Internat Security Association"SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: